

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"ARVES" SHPK

Në Tiranë, sot më datë 25/04/2024 në selinë e shoqërisë, me zyrë në adresën: < *Vlorë, Drashovicë, godine private në ZK. 3362, nr. Pasurie 456/5*, u paraqit personalisht ortaku themelues si më poshtë:

Z. Armand Çepaj, shtetas Shqiptar, atësia Vesel, lindur më 05.05.1976 në Drashovicë dhe banues në Drashovicë, Vlorë, gjendja civile "I martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar me Kartë Identiteti me nr. **032946157** dhe me Nr. Personal **H60505063E**, I cili harton këtë Akt Themelim të Shoqërisë "ARVES" SHPK, mbeshetur në ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, ligjin 9723 datë 03.05.2007 "Për Qëndrën Kombëtare të Biznesit", Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, si më poshtë:

KREU I

Neni 1
Krijimi

Shoqëria "ARVES" SHPK, është person juridik i të drejtës shqiptarë, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë e quajtur "Shoqëria").

Neni 2
Personaliteti iuridik

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qëndrën Kombëtare të Biznesit (QKB), në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.


Shoqëria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Shoqëria "ARVES" shpk. është një shoqëri, që themelohet nga ortaku i vetëm **Z. Armand Çepaj** i cili përballon humbjet vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tij në kapitalin themeltar.

Neni 3
Selia

Shoqëria e ka selinë në **Vlorë, Drashovicë, godine private në ZK. 3362, nr. Pasurie 456/5**.

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyrë përfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të Ortakut/Ortakëve të Shoqërisë.



Neni 4
Objekti i veprimtarise

Objekti i veprimtarisë së kësaj shoqërie është:
Ndermjetesime dhe përfaqesime tregëtare.

Neni 5
Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

KREU II
KAPITALI

Neni 6
Kapitali Themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 1.000 leke (njëmijë lekë).

- a) Ortaku **Armand Çepaj** është zotërues i 1 (një) kuote me vlerë nominale 1.000 lekë, që përbën 100% të kapitalit themeltar.


Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme. Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta). Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cënimit apo shperblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cënimit të këtyre të drejtave. Kjo e drejtë parashkruhet brenda 3 vjetëve nga çasti i cënimit.

Neni 7
Menyrat e fitimit dhe kalimit te kuotave

Kuotat e kapitalit, të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- d) dhurimit;
- e) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim. Statuti mund të kushtëzojë kalimin e kuotave, veçanërisht duke përcaktuar miratimin e shoqërisë ose të drejtën e parablerjes në favor të shoqërisë apo të ortakëve të tjerë.



Në rastet e kalimit të kuotave me kontratë, kushtet dhe momenti i kalimit të titullit të pronësisë mbi kuotën, si dhe kushtet e tjera të kalimit, përfshirë momentin e pagësës së çmimit, rregullohen nga kontrata. Kontrata për kalimin e kuotës hartohet në formë shkresore dhe noterizimi nuk përbën kusht për vlefshmërinë apo regjistrimin e kontratës. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet shprehimisht ndryshe nga ligji apo kur palët bien dakord në kontratë, vlefshmeria e kalimit të titullit të pronësisë mbi kuotat nuk do të kushtezohet nga kryerja e formaliteteve të ndryshme me efekt deklarativ, përfshi këtu formalitetet e Biznesit ose të publikimit të kontratës apo të kalimit të titullit.

KREU III ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi vendimmarrës

Asambleja e Ortakut/Ortakëve të vetëm është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakut/Ortakëve të vetëm është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja Ortakut/Ortakëve të vetëm është pëëgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- d) emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- e) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "d" të kesaj pike;
- f) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- h) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- i) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- j) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në proçedimet e tjera ndaj administratorëve;
- k) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- l) miratimin e rregullave proçedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- m) Kreditimin në çfarëdo bankë apo institucion financiar kreditor.
- n) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblese së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9
Administrimi

Shoqëria do të administrohet nga një administrator **Z. Armand Çepaj**, shtetas Shqiptar, atësia Vesel, lindur më 05.05.1976 në Drashovicë dhe banues në Drashovicë, Vlorë, gjendja civile "I martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar me Kartë Identiteti me nr. **032946157** dhe me Nr. Personal **H60505063E**, sipas statutit dhe ligjit për një periudhë 5 vjeçare me të drejtë ripërtëritje.

Asambleja e ortakut/ortakëve të vetëm, mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë. Statuti, apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë.

Pervç kësaj, administratori shkarkohet nga gjykata për shkelje të ligjit me kërkesë të çdonjërit prej ortakëve. Tagrat e përfaqësimit të administratorit dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Emërimi i administratorit prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.


Administrator i shoqërisë mund të emërohet edhe një person jashtë ortakërisë.

Neni 10
Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d) përgatiti dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- e) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarevajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- f) kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- g) raportojë përpara asamblesë së ortakut/ortakëve të vetëm në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- h) kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligje dhe në statut.

Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm. Administratori përfaqësonë Shoqërinë përpara të gjithë personave fizikë e juridikë, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të të gjitha shkallëve, bankat e të gjitha niveleve etj. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, si përpara



Bankave të të gjitha nivele, për të kryer derdhje, tërheqje, transfertë, etj, përpara Zyrate të Tatimit Taksave, Zyrate të Qeverisjes Vendore, Zyrate të Punës, Autoriteteve Doganore, etj, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakëve të shoqërisë. Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Neni 11
Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 12
Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar. Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 13
Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 14
Dispozita përfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua në 3 ekzemplarë me përmbajtje dhe vlera të njejtë juridike, në gjuhën shqipe, u miratua në parim nen për nen nga Ortaku i shoqërisë tregëtare "ARVES" shpk, dhe nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën orgjinale.

**ORTAKU THEMELUES I SHOQËRISË
"ARVES" SHPK**

Armand Çepaj

